

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE:**

**"PRODHIMI, INSTALIMI I PRODUKTEVE  
ELEKTRONIKE, SI EDHE CMONTIMI DHE  
RIGJENERIMI I TYRE"**

**Vendodhja:** Autostrada Durres – Tirane, KM 1,  
lagjia 14, Bashkia Durres, Qarku Durres.

**Kërkues:** Subjekti: "REWORK COMPANY" Sh.p.k

**Hartoi:**

**"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k**  
(Çert. Nr. 551 Prot, dt. 24.10.2008)

Administrator  
Elidiana Shehu



Janar, 2020

# PËRMBAJTJA

Kapitulli 1	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....	1
1.1.	Qëllimi i Projektit .....	1
1.2.	Vendodhja e zonës së impiantit .....	1
1.3.	Informacion për qendrat e banuara në afërsi të zonës së impiantit .....	2
1.4.	Përshkrimi i projektit teknik .....	4
Kapitulli 2	PËRSHKRIMI I MJEDISIT .....	7
2.1.	Mjedisi fizik.....	7
	Gjeologjia .....	7
	Gjeomorfologjia.....	7
	Ujërat.....	7
	Tokat.....	9
	Klima.....	9
2.2.	Mjedisi biologjik.....	10
	Përshkrimi i habitateve kryesore në zonën e projektit, si dhe harta ilustruese .....	10
2.3.	Zonat e Mbrojtura .....	13
2.4.	Cilësia e mjedisit në zonë .....	14
	Cilësia e ajrit në zonë.....	14
	Niveli i zhurmave ne zonen e studiuar .....	17
Kapitulli 3	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....	18
3.1.	Metodika e vlerësimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis.....	18
3.2.	Lloji i ndikimeve te identifikuara .....	18
3.3.	Ndikimet pozitive ne mjedisin e zones se projektit .....	19

## **TABELAT:**

Tabela 1	Monitorimi i ajrit per qytetin e Durresit .....	14
Tabela 2	Numri i ditëve qe tejkalojne normen ditore te PM10 prej 50 µg/m <sup>3</sup> .....	15
Tabela 3	Niveli i monitoruar i zhurmave urbane .....	17

## **FIGURAT:**

Figure 1	- Harta hidrogjeologjike e zonës në vlerësim .....	8
----------	--	---

# Kapitulli 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

## 1.1. Qëllimi i Projektit

Shoqëria 'Rework Company' sh.p.k e themeluar me 30/09/2016, ushton aktivitetin e saj ne fushen e prodhimit dhe instalimit te produkteve elektronike dhe elektrike si dhe ne cmontimin dhe rigjinerimin e tyre. Aktiviteti do te zhvillohet me material porosites nen regjimin e perpunimit aktiv, ku te gjitha materialet dhe lendet e para te marra nga porositesi pasi te kalojne ne proceset e percaktuara ne skedat teknike te produktit, do te kthehen perseri ne vendin e origjines.

## 1.2. Vendodhja e zonës së impiantit

Subjekti "Rework Company" sh.p.k qe ka per qellim te veri ne funksion aktivitetin: "Perpunim dhe Montim i Produkteve Elektronike" , do e zhvilloje aktivitetin e tij ne nje nga kapanonet e marra me qera, me vendodhje ne lagjen 14, autostrada Tirane-Durres, Durres. Kjo zone eshte nje zone industriale e perbere nga disa kapanone ne te cilen zhvillojne aktivitetin shume kompani te tjera. Njesia e qeverisjes vendore e cila administron territorin ku zhvillohet aktiviteti eshte Bashkia Durres.



Ortofoto e zones se projektit

### 1.3. Informacion për qëndrat e banuara në afërsi të zonës së impiantit

**Zona Gjeografike:** Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë.Kurbin,



**Popullsia:** Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km<sup>2</sup>ndërsa sipas Regjistrit Civil është 680 banorë km<sup>2</sup>.

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz.

Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

## Bashkia Durrës

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM <sup>2</sup>
Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës	175,110	299,989	338.3
		Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori			
		Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,			
		Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fillakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik			
		Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj,			
		Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kameras, Radë, Shkallë, Fshat Manëz			

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Durrësi ka gjithashtu portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njën më të rëndësishme tregtare në vend.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike. Zbulimet arkeologjike janë të shumta, ndërsa ndërtimet e dekadave të fundit kanë dëmtuar një pjesë të kësaj trashëgimie.

Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës.

Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 750.000 vizitorë në vit, kjo është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 54,000 njerëz. Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21.3%.

Nga pikëpamja administrative, prona ku do të zhvillohet aktiviteti për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe mbetjeve nga kafshët ndodhet në fshatin Kosmac, Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau – Dejes, Qarku Korçë.

Vendi ku do të zhvillohet aktiviteti, ndodhet në një zonë mikse urbane dhe industriale. Në figurën më poshtë paraqitet pozicionimi i pronës ku do të zhvillohet projekti për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe mbetjeve nga kafshët. Distanca e pronës ku do të instalohet incineratori model Rotomac 6000 ka një distancë të konsiderueshme nga lumi Drin që rrjedh në veri të pronës. Distanca nga lumi Drin është rreth 2.5 kilometra në Veri.

Persa i përket zonave të banuar, në afërsi të pronës janë identifikuar disa banasa të shpërndara në mënyrë sporadike. Zona në fjalë karakterizohet nga zhvillime urbane dhe zhvillime ekonomike, kjo për faktin se në këto zone kalon rruga nacionale Lezhë – Shkoder, e cila krijon lehtësira për transportin urban të qytetarëve por edhe një ndihmë të madhe për aktivitetet ekonomike që janë zhvilluar në zonë.

## **1.4. Përshkrimi i projektit teknik**

Proceset e punës zakonisht do të bëhen manualisht nga punonjësit, ku procesi kryesor është ai i saldimit të skedave elektronike manualisht nga punonjësit duke përdorur kallajin e pastër si element për saldimit. Gjithashtu në prodhimin e skedave elektronike përveç proceseve manuale do të ketë dhe procese të automatizuara. Kompania nëpërmjet përdorimit të makinerisë ZEVAV Selective Soldering System, mundeson automatizimin e prodhimit të skedave elektronike.

### **Kjo makineri vëhet në funksionon me anë të energjisë elektrike.**

Skedat elektronike hyjnë në makineri në zinxhirin e njëra pas tjetres dhe saldohen komponentet e duhura në skedë. Makineria nëpërmjet përdorimit të azotit redukton oksigjenin nga makineria dhe bën të mundur një saldimit të persosur të skedave elektronike. Bashkangjitur do të gjëni planin e vendosjes të skemës prodhuese si dhe skedën teknike të makinerisë që do të përdoret.

Materialet që do të përdoren për prodhimet e pjeseve të ndryshme të produkteve elektronike janë siç është, rrota, fasheta, unaza, siguresa, vida, kavo akceleruese, skeda, ngjitëse, kabull, kit centralizator, pjesë të GPS, qese të transparente, kuti kartoni, letra të lagura, kallaj.

### **Specifikimi I makinerisë GS331**

#### **1.1 Informacion I Përgjithshëm**

##### **1.1.1 Zona e aplikimit**

Sistemi i saldimit selektiv ZEVAV është një makinë automatike e dizenuar për ngjitjen e bordeve qarkore të printuara (PCB) përmes vrimave perfshe komponentët SMD.

Kjo makineri siguron nje mjedis te sigurt per nje cilesi te larte saldimi , PCB transportohen nga një sistem transportimi mbi stacionin e fluksit dhe stacionet e nxehjes paraprake . Me pas njësia e makinerise siguron fleksibilitetin e transportimit të PCB mbi stacionet e saldimit. Makineria ka shumë funksione standarde ka dhe funksione fakultative që mund të shtohen me ane te një makinë konfigurimi.

Sistemi i saldimit selektiv ZEVAv është projektuar ne perputhje me Direktivat Evropiane të CE.


### 1.1.2 Materialet e përdorura

Të gjitha kimikatet e përdorura nga konsumatorët duhet të jenë në përputhje me materialet e përdorura nga kompania qe ka projektuar kete pajisje, të tilla si: Elastomer Fluorocarbon, PVC (klorur Polyvinyl), PVDF (fluoride Polyvinylidene), çelik dhe alumini. Për të shmangur korrozionin e rende në makineri per pastrim perdoren vetem solucione jokorrodues .

Ka flukse të cilat nuk duhet të hiqen nga tubat PCB pas saldimit.

### Dimensionet e produktit

SPECIFIKIMI PCB DHE PALETAT	
Min-Max I gjerësis se PCB të saldueshme	100 - 250 mm (3.94- 9.85 inch)
Min-Max I gjatësis se PCB të saldueshme	150 - 350 mm (5.90-13.78 inch)
Min-Max I gjerësis se paletes	100 - 310 mm (3.94-12.20 inch)
Min-Max I gjatësis se paletes	150 - 410 mm (5.90-16.14 inch)
Pozicioni I PCB ne Palet	PCB ne qoshe te paletes . 30mm (1.18 inchnga pjesa e perparme e paletes dhe 30 mm (1.18 inch) nga pjesa e perparme e hekurit
Trashësia e produktit	0.8 – 3 mm (0.03-0.118 inch)
Pesha e produktit	Max 10 kg (22.05 lb)
Lartësia e pjesës së sipërme të komponentit	Max 120 mm (4.72 inch)
Lartësia e pjesës së poshtme të komponentit	Max 25 mm (0.98 inch), 16 mm (0.63 inch)ne valezimin e shumefishte
Pastrimi i skajit të PCB-së	Min 3 mm (0.118 inch)
PCB e rrafshet (% e PCB diagonale)	Max 1 %



## 1.2 Konfigurimi

Një makinë ka fusha dhe stacione të ndryshme. Në çdo zonë ose stacion, ndodh një nga proceset e saldimit. Zonat dhe stacionet kanë të njëjtin numër për çdo konfigurim makine.

Nëse një zonë ose stacioni është i varur nga konfigurimi i makinës.

Disa zona ose stacione mund të jenë bosh për një konfigurim të makinës.



ST1 -Stacioni Fluxer

ST2 - Stacion I Ngrohje paraprake

ST3 - Stacion I Ngrohje paraprake

ST4 - Stacion I Ngrohje paraprake

ST5 -Stacioni I levizjes

SA1 - Zona e lidhjes 1

SA2 - Zona e lidhjes 2

SA3 - Zona e lidhjes 3



## **Kapitulli 2 PËRSHKRIMI I MJEDISIT**

### **2.1. Mjedisi fizik**

#### ***Gjeologjia***

Tokat në zonën ku propozohet të zbatohet projekti janë toka të kripura sodike. Tokat e kripura janë toka të formuara mbi depozitime aluviale lumore dhe detare, me teksturë të lehtë (ranore) dhe më pak mbi ato liqenore e kënetore me teksturë të hollë, në kushte të klimës mesdhetare fushore të ndikuar nga deti, ku regjimi ujqor veçanërisht gjatë verës është djersitës (raporti reshje:avullim është më i vogël se 1). Përgjithësisht gjenden në fusha me kuotë të ulët, shpesh nën nivelin e detit, që në mënyrë periodike ose të përhershme janë të ngopura me ujë. Të formuara në kushtet kur evapo-transpirimi mbizotëron mbi reshjet dhe ujitjen në një pjesë të konsiderueshme të vitit, kripërat që përmbahen në tretësirën tokësore, pas avullimit të ujit, mbeten dhe akumulohen në sipërfaqe ose në një farë thellësie.

Në zonën në studim janë të përhapura tokat e nëntipit të kripura sodike, për të cilat karakteristike është ndërthurja e procesit të kripëzimit me atë të sodifikimit. Këto toka kanë strukturë të mirë por për shkak të shpëlarjes progressive, kjo strukturë mund të prishet. Në prishjen e strukturës ndikon edhe rritja e përqindjes së Na. Për rrjedhojë, ulet në mënyrë të ndjeshme përshkueshmëria nga uji, kushtet fizike të tokës, vështirësohet plugimi etj.

Për shkak të nivelit të lartë të kripës dhe efektit toksik të Na (i cili gjendet në përmbajtje të lartë), rritja e bimësve në këto toka është e vështirë dhe fauna tokësore është pak aktive në këto mjedise.

#### ***Gjeomorfologjia***

Zona e propozuar për zhvillimin e projektit gjendet në pjesën perendimore të vendit. Relievi karakterizohet nga pjerrësi e vogël me drejtim nga periferia në qendër, e cila kushtëzohet nga mënyra e formimit të saj. Pjesa më e madhe e saj në të kaluarën zihej nga kënetat e Durrësit, e cila kishte trajtën e një lagune pasi lidhej me detin nëpërmjet kanalit të Porto Romanos. Si rrjedhojë e bonifikimit kjo kënetë u tha dhe u përfituan rreth 7 800 ha tokë arë.

#### ***Ujërat***

Zona është e varfër në burime ujore sipërfaqësore natyrore por përshkohet nga një rrjet i dendur kanalesh kulluese, prania e të cilave i dedikohet kryesisht punimeve të kryera për bonifikimin e ish kënetës së Durrësit. Rreth 10 km në vijë ajrore në veri është grykëderdhja e Erzenit, i cili rrjedh në lindje dhe veri të zonës. Rreth 5 km në perëndim të saj shtrihet vija bregdetare e Adriatikut.




Figure 1 - Harta hidrogjeologjike e zonës në vlerësim

### Ujërat nëntokësorë

Zona shtrihet nën pellgun ujëmbajtës të rrjedhjes së poshtme të lumit Erzen, ujërat e të cilit ndahen në dy grupe kryesore:

Ujëra nëntokësore të shkëmbinjve të shkrifët ose kompleksi i depozitimeve Kuartenare, të cilat takohen në shtresat me përshkrueshmëri të vogël deri të mjaftueshme, të tipit lagunor- kënetor, të formuar në fushën e ish Durrësit. Shtresa kolektore ujëmbajtëse e rërave të imta që takohet në fushën e Durrësit ka përshkrueshmëri të dobët dhe veti kolektore të vogla. Karakteri lokal dhe i kufizuar i veçorive ujëmbajtëse të këtyre shtresave shpjegohet me faktin se ato shtrihen në formë "Oreole" mbi ujërat e kripura detare, të cilat kanë desitet më të madh se ujërat e ëmbla. Duke u ndodhur në kushte të tilla, shfrytëzimi i këtyre ujërave pa kriter dhe sasi më të mëdha se ato të rekomanduara, sjell menjëherë prishjen e ekuilibrit hidrogjeologjik ekzistues me pasojë depërtimin e ujërave të kripura detare dhe prishjen e cilësisë së tyre, duke i bërë ato praktikisht të pashfytëzueshme.

Ujërat nëntokësore të shkëmbinjve kompakte ose i shkëmbinjve mollasik. Meqënëse depozitimet argjilo – alevrolite të Pliocenit përbëjnë ekranin e papërshkrueshëm argjilor, kompleksi ujëmbajtës në pakot ranore të depozitimeve të Mesinianit, brenda rajonit të studiuar, ka përhapje të vogël dhe tregues hidrodinamikë të vegjël.

Thellësia e ujërave nëntokësore nga sipërfaqja e tokës, në rajonin e ish kënetës së Durrësit arrin 0.5 deri 3.0 m. Gjatë periudhës së thatësisë së verës niveli i ujit ulet 3.0-5.0 m, ndërsa gjatë dimrit 0.2–0.3 m. Në ekstremin perëndimor e lindor të rajonit kemi të bëjmë me ujëra nëntokësore me shtrirje të nivelit në thellësinë mbi 5.0 m nga sipërfaqja e tokës. Në këto thellësi ujërat nëntokësore janë të tipit artezian, ato takohen në ndërshtresa ranoro- konglomeratike të cilat janë të izoluara nga sipërfaqja e tokës nga një shtresë e përshkrueshme argjilore, por që gjatë shpimit këto ujëra ngrihen dhe dalin me vetëdhije në sipërfaqe.

### **Tokat**

Karakteristike për zonën ku propozohet të realizohet ndertimi i objektit me destinacion arsimi, janë Tokat e Hinjta Kafe. Formimi i tyre kushtëzohet nga klima mesdhetare kodrinore, që karakterizon zonën dhe shkëmbinjtë terrigjenë që e përbëjnë atë. Karakteristikë e përgjithshme e këtyre tokave është ngjyra e hinjtë kafe, përbërja mekanike më e rëndë në horizontin B, reaksioni neutral dhe lehtësisht bazik. Këto janë toka minerale, me shkallë të ndryshme të diferencimit të profilit dhe prirje argjilizimi në shtresën e mesme të tij. Formula e profilit të tokave të hinjta kafe është A1-A2-AB-BC-C ose A-AC-C. Ato kanë përmbajtje mesatare humusi dhe azoti në horizontin A, të varfra me P, të pasura me K dhe CaCO<sub>3</sub>, si dhe të saturuara me baza. Këto toka kanë përgjithësisht cilësi dhe strukturë fizike të mirë për shkak të përmbajtjes së humusit, CaCO<sub>3</sub> dhe bazave në kompleksin thithës.

### **Klima**

Shtrirja përgjatë bregdetit Adriatik, ndikimi aktiv i detit, relievi i ulët fushor, vargmalet që e rrethojnë nga lindja me shtrirjen e tyre karakterisike veriperëndim-juglindje dhe që e mbrojnë nga erërat e ftohta dhe të forta kontinentale, janë faktorët themelorë që kushtëzojnë veçoritë klimatike të zonës në studim.

Rajonit ku gjendet zona e propozuar për zhvillimin e aktivitetit bën pjesë në zonën me klimë mesdhetare fushore, nënzona qëndrore. Regjimi klimatik i kësaj zone është tipik mesdhetar. Temperatura mesatare vjetore është 16.1°C. Në muajt e verës temperatura mesatare luhetet midis 23.6°C dhe 26°C, ndërsa në muajt e dimrit temperatura mesatare është rreth 8.9°C. Muaji më i nxehtë i vitit është gushti. Temperatura maksimale absolute arrin në 39-40°C ndërsa ajo minimale është -7.4°C. Vlerat e temperaturave të vegjetacionit lëkundën në rreth 5000 orë duke e bërë zonën shumë të favorshme për rritjen e mjaft kulturave bujqësore.

Për shkak të veprimtarisë së gjerë ciklonare sasia më e madhe e reshjeve vihet re në gjysmën e ftohtë të vitit ndërsa ajo më e ulët në periudhën e ngrohtë të tij. Sasia mesatare vjetore e reshjeve të zonës në studim, të cilat bien kryesisht në formë shiu, është 972 mm. Sasia më e madhe, rreth 70%, bie gjatë periudhës tetor-shkurt. Minimumi vjetor i regjistruar në zonë është 640 mm ndërsa vlera maksimale e tyre është 1550 mm. Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor me 132.9 mm, i ndjekur nga dhjetori me 113 mm. Më pak reshje regjistrohen në korrik me një mesatare 23.9 mm. Numri i ditëve me reshje ≥1.0 mm varion nga 2.4 ditë (korrik) deri në 11.1 ditë (dhjetor). Gjatë vitit ka mesatarisht 86.4 ditë me reshje ≥1.0mm.

Era është një tjetër element i rëndësishëm klimatik. Në përgjithësi mund të thuhet se zona karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë (rreth 53% të kohës) dhe shpejtësi mesatare minimale 1.2m/s gjatë verës dhe shpejtësi mesatare maksimale 2.1–2.4 m/s në dimër. Erërat që fryjnë nga verilindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4.7 m/s.

Në pranverë shfaqet drejtimi i dytë dominues, jugperëndimi me rastisje 11.9%. Ndikimi i jugperëndimit vazhdon të jetë i fortë gjatë verës, ndërsa gjatë vjeshtës forcohet përsëri veprimi i erërave verilindore. Drejtimi veriperëndimor arrin vlera të larta shpejtësie në vjeshtë, por ndikimi i tij është i papërfillshëm për shkak të rastisjes së ulët prej 1.3%.

## 2.2. Mjedisi biologjik

### *Përshkrimi i habitateve kryesore në zonën e projektit, si dhe harta ilustruese*

Sipërfaqja e studimit shtrihet në Shkozë, përgjatë autostradës Tirane – Durrës. Zona përfshin vetëm mjedisin urban, i cili kufizohet në distance të largët nga toka bujqësore dhe me bar.

### **Metodika e vërtimit të florës**

Në zonën e studimit janë kryer vërtime, ku janë plotësuar të dhëna të përgjithshme për vendodhjen, sipërfaqen, pjerrësinë, kundrejtimin e diellit, përbërjen floristike, si dhe sasi- mbulesën. Vlerësimi i florës është bërë përmes *metodikës së vlerësimit të shpejtë*, e cila ka si qëllim inventarizimin e llojeve, përcaktimin e sasi mbulesës, lidhjen e ndërsjellë midis formacionit tokësor dhe bimësisë, si dhe faktorët që ndikojnë në habitatin në studim. Inventarizimi dhe përcaktimi i shoqërimeve bimë është përdorur duke ndjekur *metodikën e arealit minimum*, e cila konsiston në inventarizimin e llojeve të sipërfaqes bimë, brenda së cilës nuk ka dallime të theksuara të përbërjes floristike. Për këtë, janë përcaktuar paraprakisht dhe ndjekur transektet bazuar në mbulesën bimë përfaqësuese, me gjatësi nga 100 – 200 m. Numri më i madh i llojeve është përcaktuar direkt në terren, ndërkohë llojet e panjohura janë vendosur në herbar dhe janë përcaktuar në mjedisin e punës, duke u bazuar në librin “Flora Ekskursioniste e Shqipërisë”, si dhe studime të tjera në afërsi të zonës në studim. Habitatet dhe llojet janë dokumentuar nëpërmjet fotografive të bëra në terren. Ndërkohë, krahas interpretimit, të dhënat e mbledhura në terren janë hedhur në data – bazë (emërtimi në latinisht dhe shqip, lista e llojeve në varësi të habitatit, statusi, dhe prezenca).

Më poshtë jepet një përshkrim më i detajuar për llojet floristike të vëzhguara drejtpërdrejt në zonën e studimit.

### **1. Zone urbane**

Zona e studimit karakterizohet nga mjedis me infrastrukture urbane dhe përfshin habitate teresisht të modifikuara, ku janë mbjelle disa bimë dekorative. Sipërfaqja e gjelbër ka shtrirje të kufizuara me kundrejtim nga jugu dhe përfshin shumë pak lloje, si: Krisja (*Cynodon dactylon*), Ulliri (*Olea europaea*), Mëllagë (*Malva sylvestris*, *Pelargonium inquinans*, *Pelargonium acraeum*), Dredhez e ares (*Convolvulus arvensis*), Krizanteme (*Chrysanthemum japonense*), Palme (*Trachycarpus fortunei*), Tuje (*Thuja orientalis*), dhe Pjeshke (*Prunus persica*). Pjesa tjetër e zonës është teresisht e betonizuar dhe pa vegjetacion duke bërë që dhe diversiteti i llojeve faunistike të jetë shumë i vogël. Megjithatë me vlerë të ulët botanike, habitatet kanë rëndësi për fizionominë që i jep peisazhit urban zonës.

### *Habitatet kufizuese*

### **2. Tokat bujqësore dhe bimë të djerrinave.**

Perveç qendrave të banuara, habitatet natyrore me të afërta me zonën e studimit janë ato të tokave me bar si dhe tokave bujqesore. Këto mjedise janë të rëndësishme pasi strehojnë lloje që përdorin zonën e studimit si korridor kalimi, apo në disa raste dhe për kërkimin e ushqimit.

Zona kufizuese e mozaikut bujqësor është me kundërtim nga jugu dhe pjerrësi deri në 5%. Mbulesa bimëore përbëhet nga bimësi barishtore e kultivuar (95%), si: grurë (*Triticum vulgare*), jonxhë (*Medicago sativa*) dhe miser (*Zea mays*). Hortikultura është e përfaqësuar nga individë të rrallë të manit të bardhë, hardhi rrushi, ullinj, etj. Ndërkohë, sipërfaqe të braktitura se afërmi kanë prirjen të mbulohen nga bimësi oportuniste si manaferra (*Rubus ulmifolius*), mëgushtra (*Dittrichia viscosa*), Telishi (*Dactylis glomerata*), flokëza qepore (*Poa bulbosa*), luledele (*Bellis perennis*), Hithra (*Urtica dioica*), Këputje arash (*Equisetum-arvense*), etj. Mungesa e bimëve të rrezikuara dhe endemike tregon vlerë të ulët botanike të këtyre mjedisve.



Mjedis natyror në zonë e studimit është i modifikuar dhe me bimë dekorative.

## Fauna

### Metodika e vrojtimit të faunës

Inventarizimi i llojeve të faunës në zonën e studimit është kryer duke përdorur mjete ndihmëse si aparat fotografik, dylbi, dhe celsa të identifikimit. Vrojtimet janë kryer me metodën direkte (evidentimi i kafshës në habitat) dhe indirekte (gjurmë në tokë, fece, fole, shënja në ngrënie, gjurmë në tokë), duke patur si objekt 4 grupe të vertebrorëve (gjitare, shpendë, reptilë, dhe amfibë). Gjithashtu u morën dhe informacione shtesë nga bujqit e zonës për llojet e kafshëve të para në të. Për përcaktimin e llojeve janë përdorur botimet shkencore si: “Shpendët dhe Gjitaret e Shqipërisë”, “Collins Mammal of Europe”, “Collins Bird Guide”, Collins Field Guide Amphibians and Reptiles”, si dhe studime të tjera në afërsi të zonës në studim. Të dhënat e marra janë hedhur në data – bazë (emërimi në latinisht dhe shqip, preferencë në habitat, prania, statusi).

### Përshkrim i detajuar i llojeve faunistike të zonës në studim.

Bazuar në vrojtimit në terren, në botimet e publikuara për zonat në afërsi, si dhe në kërkesën e llojit për habitat, vlerësohet se në zonën në studim gjenden 29 lloje vertebrorë, ku përfshihen amfibë, reptilë, shpendë dhe gjitarë. Zona e studimit ka infrastrukture urbane dhe me bime dekorative. Si rrjedhim, ajo përfaqësohet nga numër i vogël llojesh dhe popullata me densitet të ulët të tyre. 15 lloje vertebrorësh u vrojtuan në terren gjatë monitorimit. Ndërkohë, vlerësohet se në bazë të kërkesës së llojit për habitat, shpërndarjes gjeografike, ekologjisë së llojeve, si dhe të dhëna nga studime të ngjashme të zonave në afërsi, në zonën e studimit mund të gjenden edhe 14 lloje të tjera. Nga totali i kafshëve të evidentuara, 2 lloje janë me status të ekspozuar ndaj rrezikut (VU), 1 lloje janë me status në rrezik (EN) dhe 4 te tjera janë pak të rrezikuara (LR). Më poshtë jepet një përshkrim i detajuar i faunës së pranishme në zonën e studimit.

Në tabelën e mëposhtme (Tabela A) jepen të dhëna mbi numrin e llojeve të rrezikuara.

**Tabela A** Listat e llojeve në zonën në studim

Grupi	Numri i llojeve	Stausi kombëtar
Gjitaret	4 (79)	4
Shpendet	20 (354)	3
Reptilet	3 (37)	3
Amfibet	2 (16)	2
<b>Total i vertebrorëve</b>	<b>29 (486)</b>	<b>12</b>

**Gjitaret** – Ky grup në zonën e studimit përfaqësohet me shumë pak lloje për shkak të modifikimit dhe mungesës së mjedisit natyror. Vlerësohen të jenë të pranishme vetëm disa lloje brejtësish të vegjël



(*Rattus rattus*, *Rattus norvegicus*, *Mus musculus*). Lloje te tilla kane si diete ushqimet e magazinuara, mbeturinat, frutat, vemjet, etj. Si rrjedhim, ata kane aftesi te larte pershtatese ne habitatet rurale dhe urbane. Nderkohe, brejtesit e tjere qe mund te vizitojne zonen, jane te lidhur me tokat me bar qe jane kufizuese te zones se studimit.

**Shpendët** – Habitatet në studim mbështesin një numër të vogël shpendësh krahasuar me numrin total që gjenden në Shqipëri. 5 lloje janë evidentuar gjatë vrojtimeve në terren, ndërkohë 15 të tjerë vlerësohen potencialisht të pranishme bazuar në studime të ngjashme të zonave në afërsi, si dhe në kërkesën e llojeve për habitat. 70 % e tyre janë të përhershëm dhe 30 % e tyre janë verues. Ndërkohë nga këta, 1 lloj ka statusin i rrezikuar (EN), 1 lloj është i kërcënuar (VU) dhe 1 tjetër ka statusin pak të kërcënuara (LR). Nder llojet me te zakonshme jane harabeli i shtepise (*Passer domesticus*), dallendyshet (*Hirundo sp.*, *Delichon urbica*), sorrat (*Pica Pica*, *Corvus cornix*, *Corvus monedula*), pellumbi (*S. decaocto*), etj. Lloje te tjera preferojne habitatet e tokave me bar dhe kopshtet qe kufizojne zonen e studimit, duke përfshirë gushekuqin, turtullin, gargullin, etj.

**Reptilët** – Diversiteti i reptilëve në zonën e studimit paraqitet i ulët në lloje. Në bazë të studimeve vlerësohet se në këtë zonë janë të pranishëm 3 lloje reptilësh. Llojet më të zakonshme përfaqësohen nga zhapijtë (*Podarcis muralis*, *Podarcis taurica*) dhe breshka e zakonshme (*T. hermani*). Llojet e evidentuar gjatë punës në terren frekuentojnë habitatet tokave të hapura me bar dhe shkurretat që formohen rreze mureve dhe ne ane te rruges. Ndërkohë, asnjë nga to nuk bën pjesë në listën e llojeve të rrezikuara.

**Amfibët** – Zona në studim ka shtrirje të vogël dhe dominohet kryesisht nga sipërfaqe tokësore. Ne pjesen e tokave me bar qe kufizojne zonen e studimit, mund të gjendet bretkosa e zakonshme e gjelbër (*P. kurtmuelleri*), për shkak të valencës së gjerë ekologjike dhe thithlopa (*B. bufo*) përgjatë tokave bujqësore, në afërsi të rrjedhjeve ujore.

### 2.3. Zonat e Mbrojtura

Zonat e Mbrojtura bashkë me Monumentet e Natyrës përfaqësojnë një rrjet sipërfaqesh që mbrohen në shkallë të caktuar, sipas përcaktimeve kategorike të tyre, për shkak të vlerave natyrore kombëtare, por edhe rajonale e globale.

Referuar versionit më të fundit të Hartës së rrjetit të ZM të publikuar nga Ministria e Mjedisit ([http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Biodiversiteti/Rrjeti\\_i\\_ZM\\_DBZM\\_Maj\\_2016.pdf](http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Biodiversiteti/Rrjeti_i_ZM_DBZM_Maj_2016.pdf)) zona në të cilën gjendet objekti yne nuk ndërpret asnjë Zonë të Mbrojtur ose Monument Natyre dhe Kultures.

## 2.4. Cilësia e mjedisit në zonë

### Cilësia e ajrit në zonë


Monitorimi i ajrit për qytetin e Durrësit është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për periudhën kohore shkurt-dhjetorë 2016 për indikatorët kryesorë të cilësisë së ajrit, si: CO, SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, O<sub>3</sub>, grimcat e pluhurit me diametër më të vogël se 10 dhe 2.5 mikron (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>) dhe Benzeni (µg/m<sup>3</sup>). Nga stacionet automatike janë regjistruar dhe përpunuar të dhëna mesatare ditore, mujore dhe vjetore.

Nr	Stacionet	Vendndodhja	Treguesit
1	Durrës	Oborri i shkollës "Jusuf Puka"	PM <sub>10</sub> /PM <sub>2.5</sub> , SO <sub>2</sub> , NO <sub>2</sub> , O <sub>3</sub> , CO, BTEX

Tabela 1 Monitorimi i ajrit për qytetin e Durrësit


### Te dhënat mesatare vjetore të PM<sub>10</sub>

#### Grafiku 1 Mesataret vjetore të PM<sub>10</sub>



Në stacionin e Durrësit vlerat mesatare vjetore të monitoruara janë nën normën e BE dhe vlerat mesatare janë 24.03 µg/m<sup>3</sup>.

#### Grafiku 2 Numri i ditëve që tejkalojnë normën e ditëve të lejuara për PM<sub>10</sub>





Një nga treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban për PM10 është dhe numri i ditëve që tejkalojnë normen ditore të BE prej 50 µg/m<sup>3</sup> nga numri i ditëve të lejuara në një vit që është 35 ditë.

Për stacionin e Durrësit kemi përafrim të numrit të ditëve të lejuar në vit .


Viti 2016 PM <sub>10</sub>	Numri i ditëve që tejkalojnë normen ditore të BE (50µg/m <sup>3</sup> )	Nr. ditëve të lejuar/vit
Durrës	34 ditë /341 ditë monitorimi	35

Tabela 2 Numri i ditëve që tejkalojnë normen ditore të PM10 prej 50 µg/m<sup>3</sup>

### Te dhenat e PM2.5

Në stacionet e Durrësit, vlerat vjetore të monitoruara janë afërsisht 50% më të ulëta se norma e BE dhe ndotja e ajrit nga PM2.5 në zonën pranë stacioneve të monitorimit nuk përbën ndonjë problem.

### Grafiku 3 Mesataret vjetore të PM2.5




### Të dhënat e NO<sub>2</sub>

Monitorimi i NO<sub>2</sub> për vitin 2016 është realizuar në Durrës, në muajin Dhjetor ku vlera e monitoruar është 41.78 µg/m<sup>3</sup> nga 40 µg/m<sup>3</sup> që është norma vjetore e BE.

Bazuar në të dhenat mesatare vjetore të monitoruara rezultojnë se nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore të BE. Vlerat më të larta vjetore janë monitoruar në stacionin e Durrësit. 24.49 µg/m<sup>3</sup>. Kjo është e pritshme sepse stacioni është instaluar pranë rrugës kryesore dhe me burim ndotjeje trafikun.


### Grafiku 4 Mesataret vjetore të NO<sub>2</sub>



## Të dhënat e SO<sub>2</sub>


Përsa i përket SO<sub>2</sub> nuk kemi tejkalim të vleres limite të BE

**Grafiku 5 Mesataret vjetore të SO<sub>2</sub>**



## Të dhënat e O<sub>3</sub>


**Grafiku 6 Mesataret vjetore të O<sub>3</sub>**



Referuar të dhënave mujore vlerat më të larta janë monitoruar në sezonin e verës e sidomos në muajin Gusht. Në ndryshim nga ndotësit e tjerë niveli i ozonit në pergjithësi është më i larte në stacionet urban background ndërsa l ulet ne stacionet e trafikut .Nivelet e larta të Ozonit në stacionet urban background ndodhin për shkak të temperaturave të larta dhe të niveleve të larta të rrezatimit diellor.

## Të dhënat e CO


**Grafiku 7 Mesataret vjetore të CO**



Gjate monitorimit te CO nuk kemi tejkallim të normës referuar dhe vlerave 8 orare theksojmë se nuk kemi tejkallim të normës 8 orare prej 10 µg/m<sup>3</sup>.

### Të dhënat e Benzenit

**Grafiku 8 Mesataret vjetore të Benzenit**



Nga monitorimi i Benzenit eshte vene re se vlerat mesataret vjetore jane më te ulta se norma vjetore e BE.

### ***Niveli i zhurmave ne zonen e studiuar***

Niveli i monitoruar i zhurmave urbane kete vit riverifikon qendrushmerine e niveleve te larta te zhurmes gjate dites, por duhet te theksojme se gjate nates ( si mesatare ) ka bere nje kercim te ndjeshem keto dy vitet e fundit me nje rritje rreth 15-20 dB(A) ne pothuajse te gjithe stacionet e monitorimit.

Trafiku eshte burimi kryesor i kesaj zhurme ne mjediset perreth kesaj zone kryesisht urbane, ku konstatohet se ka nje mbikalim te normes se lejuar, te cilat jane Laeq(diten)=52db(A), ndersa per Laeq(naten)=42db(A).

Tabela 3 Niveli i monitoruar i zhurmave urbane

Pikëmatja	Vlera Mes.Ditën	Vlera Mes Natën
1. Hyrja në Durrës	69 dB(A)	49 dB (A)

2. Përballë së Prefekturës	70 dB (A)	48 dB (A)
3. Kryqëzimi i Portit	68 dB (A)	50dB (A)
4. Drejtoria e Higjenes	67 dB (A)	46 dB (A)
5. Tek Spitali	69 dB (A)	45 dB (A)
6. Tek ish mapoja	71 dB (A)	53 dB (A)

## **Kapitulli 3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS**

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë është bërë duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e kushteve dhe vlerave egzistuese të zonës së projektit, faktorëve favorizues dhe kufizues mjedisorë për zhvillimin e projektit dhe zonave të ndjeshme fizike dhe shoqërore të identifikuar gjatë punës në terren.

### **3.1. Metodika e vlerësimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis**

Për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis nga zhvillimi i këtij projekti, u ndoqen hapat e mëposhtme;

- Njohja me bazen ligjore në fuqi;
- Njohja me projektin e zbatimit dhe teknologjinë që të përdoret;
- Njohja me ciklin e trajtimit të mbetjeve;
- Njohja me lëndët e para dhe mjetet që do të përdoren;
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese të zonës ku do të zhvillohet projekti;
- Njohja dhe shkelja nga afer e te gjithë zonës së studimit për vlerat natyrore dhe mjedisore;
- Njohja me dokumenta dhe raporte të VNM dhe veprimtarive të ngjashme;
- Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- Konsultimi me banorët e zonës dhe njësinë e qeverisjes vendore;

### **3.2. Lloji i ndikimeve te identifikuar**

#### **Ndikimi ne toke**

Ndikime ne toke nuk do te kete mbasi elementet qe do te saldohen do te jene te pergatitur me pare , te gatshem, dhe nuk do kete mbetje teknologjike te prodhimit te pjeseve elektrike apo elektronike te qarkut. Te vetmet mbetje do te jene amballazhet e pjeseve qe do te saldohen si dhe te kimikateve te

perdorur ne kete process. Keto mbetje mund te shkojne ne vendet e caktura nga Bashkia Durrës. Sa per amballazhin e elastomerit Tetrafluoroetilenit TFE qe ka do mendohet per tu depozituar ne vendet e caktuara per keto lloj amballazhesh.

#### **Ndikimi ne uje**

Elementet e perdorur per kete teknologji, nuk jane te treshem ne uje. Si rezultat nuk do tekemi ndotje te ujrave as siperfaqesore dhe as nentokesore.

#### **Ndikimi ne ajer**

Gjate procesit teknologjik te saldimit elementet e listuar ne kete linje jane pergjithesisht te ngurte.

Tetrafluoroetileni TFE eshte nje komponim organik, gas pa ngjyre dhe pa ere.

Hydrofluoroolefins (HFOs) eshte gas pa ngjyre miqesor me mjedisin.

Gjate kalimit te rrymes se azotit do te kete clirime te oksideve te azotit.

#### **Ndikimi ne biodiversitet**

Aktiviteti nuk ka ndikime ne biodiversitet

### **3.3. Ndikimet pozitive ne mjedisin e zones se projektit**

Zhvillimi i ketij aktiviteti persa i perket ndikimit social eshte pozitiv. Ky aktivitet do te punesoj banore te zones duke ndikuar ne rritjen e te ardhurave familjare.

Gjithashtu epermjet sistemit te taksimit ky aktivitet do te derdhe te ardhura ne buxhetin e shtetit.